REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 49333 126
Nr. i fq. / Br. st. -3-
Data: / Datum: 30.10.2026
VUSHTRRI - VUČITRN

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

Procesverbali nga konsultimi publik me qytetarë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë

Tetor, 2026

PROCESVERBAL

Nga konsultimi publik me qytetarë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Ora: 14:00

Data: 09.10.2026

Të pranishëm në këtë konsultim publik ishin anëtarët e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Rrahim Ajeti, kryesues i komisionit, Refik Maloku, anëtar i komisionit, Fatime Haziri, anëtare e komisionit dhe Edona Pushkolli, anëtare e komisionit.

Rrahim Ajeti, kryesues i komisionit, hapi konsultimin publik me qytetarët dhe i njoftoj për ndryshimet që janë paraparë në Statutin e Komunës së Vushtrrisë.

Më pas, fjala ka kaluar tek pjesëmarrësit në konsultim publik për të dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre për këto dy dokumente.

Liridon Lahu, zyrtar i Komunës së Vushtrrisë, propozoi ndryshimin dhe plotësimin e nenit 53 të Statutit të Komunës – Zyrat komunale. Propozimi për ndryshimin e nenit 53 të Statutit të Komunës ka për qëllim qartësimin dhe përcaktimin më të plotë të strukturës organizative të administratës komunale, përkatësisht identifikimin e zyrave dhe njësive organizative që funksionojnë krahas drejtorive komunale.

Formulimi aktual i dispozitës kërkon rishikim, me qëllim që Statuti të reflektojë më saktë organizimin institucional dhe funksionet mbështetëse, profesionale dhe të pavarura që ushtrohen në kuadër të administratës komunale. Në këtë drejtim, propozimi parasheh përfshirjen shprehimore të Kabinetit të Kryetarit/es, Zyrës së Kryetarit/es, Zyrës për Punë të Kuvendit, Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Zyrës për Komunikim me Publikun, Zyrës Ligjore dhe Zyrës Lokale për Komunitete.

Njëkohësisht, propozimi synon të ruajë fleksibilitetin e nevojshëm organizativ të komunës, duke paraparë mundësinë që Kryetari/ja i/e Komunës, në kuadër të kompetencave ligjore dhe përmes vendimit përkatës, të krijojë zyra ose njësi të tjera, kur kjo paraqitet e nevojshme për përmbushjen më efikase të funksioneve dhe përgjegjësive komunale.

Propozimi është si më poshtë:

Neni 53

Zyrat komunale

Përveç drejtorive të komunës, në kuadër të administratës komunale ekzistojnë edhe këto zyra dhe njësi:

1. Kabineti i Kryetarit/es;
2. Zyra e Kryetarit/es;

3. Zyra për Punë të Kuvendit;
4. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
5. Njësia e Auditimit të Brendshëm;
6. Zyra për Komunikim me Publikun;
7. Zyra Ligjore;
8. Zyra Lokale për Komunitete.

Përveç këtyre zyrave dhe njësive, Kryetari/ja i/e Komunës, me vendim të veçantë, mund të krijojë edhe zyra ose njësi të tjera.

Takimi përfundoi në ora 14:50.

Rrahim Ajeti – Kryetar i Komisionit

_____

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

LISTA E PJESËMARRËSVE

Konsultimi publik me qytetarë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë

Vendi: Kuvendi i Komunës

Datë: 09.10.2026

Ora: 14:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Fidai Asllani		Mihalig
2	Ziridon Zoku	Zoku	Vushtri
3	Ferki Rama	F. Rama	Vushtri
4	Festim Xhaferi		Vushtrri
5	ARBER ABAZI		SMREKONICË
6	AFRIM FAZLI		VOSHTRR
7	SAFET HYSENI		VUSHTRRI
8	Gjinolda Bllaca		Vushtri
9	FITIM	KLINAKU	
10	Xhevrit Musa		Vushtrri
11			
12			
13			
14			
15			